

Shëndeti dhe siguria në punë

Përditësimi i fundit 11 Mars 2025

Shëndeti dhe siguria në punë kanë një fokus të vecantë në politikën sociale të Republikës së Shqipërisë.

Legjislacioni për sigurinë dhe shëndetin në punë në Republikën e Shqipërisë synon të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet marrjes së masave të posacme informuese, këshilluese, parandaluese dhe udhëzuese.

Kreu VIII i Kodit të Punës dhe Kreu II, Kreu IV dhe VI i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, rregullojnë përgjegjësitë kryesore të punëdhënësit lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Të gjitha kostot që lidhen me sigurimin e shëndetit dhe sigurisë në punë janë shpenzime të punëdhënësit.

Përveç detyrimeve të vendosura në Kodin e Punës dhe në Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, punëdhënësi ka detyrime edhe nga akte dhe rregullore të tjera.

Inspektorati Shtetëror i Punës është organi përgjegjës për kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, për personat juridikë ose fizikë, publikë ose privatë, sipas përcaktimeve në legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë (neni 40 i Ligjit 10 237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar).

Të drejta të barabarta

Përveç detyrimeve në zbatim të Kodit të Punës dhe Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, punëdhënësi ka detyrime specifike të vendosura në ligje dhe rregullore të tjera.

Sipas Ligjit për të Huajt, shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, anëtarët e familjes së shtetasve të SHBA-ve, shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe të zonës Shengen dhe anëtarët e familjeve të tyre, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, shtetasit e njërit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, që janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, gëzojnë të drejtën e punësimit, pa patur nevojë për miratim për punësim, sikurse edhe shtetasit shqiptarë, përjashtuar rastet kur punësimi lidhet posaçërisht me pasjen e shtetësisë shqiptare sipas legjislacionit shqiptar (ne kuptim të nenit 80/a të 79/2021 LH).

Kushtet e punësimit të shtetasve të huaj që punojnë në Republikën e Shqipërisë nuk duhet të jenë më pak të favorshme se ato për shtetasit shqiptarë si dhe duhet të jenë në përputhje me legjislacionin shqiptar të punës (neni 74, pika 7/b LH)).

Siguria dhe shëndeti në punë, për punëmarrësit e huaj që dërgohen përkohësisht në Shqipëri, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës, për të ofruar një punë ose shërbim, rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar. Në rastet se, rregullimi që bën legjislacioni shqiptar, është më pak i favorshëm se legjislacioni i shtetit dërgues, zbatohet legjislacioni më i favorshëm për punëmarrësin (pika 2/d dhe pika 3 e neni 3/1 të KP).